



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 123, dt. 25.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.05.2016, pasi shqyrtoi projektet e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen projektet:

- Projekti "Prishje dyqani kati përdhe, rikonstruksion, shtesë e katit përdhe dhe të parë dhe papafingo" , në pronësi të z.Vasil Ylli, në rrugën "Dhimitër Rembeci", Korçë.
- Projekti "Rikonstruksion i katit përdhe, shtesë anësore, rindërtim kati i parë dhe papafingo" në pronësi të Gjergji dhe Manjola Gjata, rruga "Mihal Grameno", Nr.17, Korçë.
- Projekti "Rikonstruksion i katit përdhe, shtesë anësore, rindërtim kati i parë dhe papafingo" në pronësi të Sokol dhe Xhensila Agollit, rruga "Vasil Tromara", nr.32, lagja 12, Korçë.

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

